

N J O F T I M

Konkursi i Shërbimit të Trupit Koordinues i Qeverisë së Republikës së Serbisë për komunat Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, për ndarjen e bursave për nxënësit e shkollave të mesme në territorin e komunës së Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës, për periudhën e vitit shkollor 2014/2015, i shpallur më 02 dhe 14 tetor 2014, në gazetën Politika, ndryshohet si në vijim:

NË PIKËN - I - NUMRI I PËRDORUESVE DHE KUSHTET E KONKURSIT DHE PIKA - II - DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR PARAQITJE NË KONKURS, përveç territorit të Preshevës, Bujanocit, Medvegjës, Leskocit, Vrajës i shtohet edhe Lebani, kështu që për bursa mund të konkurojnë nxënësit të cilët kanë vendbanim në territorin e komunës së Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës dhe të cilët shkollën e mesme e kanë regjistruar në territoret e cekura më lartë.

Konkursi i shpallur për ndarjen e bursave për nxënësit e shkollave të mesme në territorin e komunave Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë, për periudhën e vitit shkollor 2014/2015, në të gjitha tjerat mbetet i vlefshëm.